



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11 mars 2019.
2. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së Komisionit.
3. Diskutimi dhe vendimi për rihapjen e procesit të kandidimit për vakancat në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Miratimi i Vendimit nr. 5/1.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Enver Reçi, Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fidel Ylli, Ismet Beqiraj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e ditës së sotme të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 11 mars dhe diskutimin e kalendarit të punës.

Përpara se të fillojmë mbledhjen, të gjithë një zëri t'i urojmë mirëseardhjen zotit Enver Roshi, i cili është deputet i ri i LSI-së dhe i bashkohet komisionit tonë. Ju e dini që ai mbulon dy sektorë, atë të profesoratisë dhe të shëndetësisë.

A keni arritur t'i hidhni një sy procesverbalit të datës 11 mars? A keni komente apo jeni dakord? Në qoftë se ndonjë prej jush ka ndonjë koment, ju e dini si është praktika, çdo sugjerim depozitohet në sekretari.

Çështja tjetër është diskutimi i kalendarit të punës së komisionit. Një kopje e tij u është dërguar të gjithë kolegëve nga ana e sekretarisë.

Ju lutem, mos harroni që gjatë muajit mars deri në datën 31, të gjitha institucionet e pavarura, të cilat janë në varësi dhe duhet të raportojnë para parlamentit, dy prej të cilëve, Radiotelevizioni Shqiptar dhe Autoriteti i Medieve Audiovizive janë të vendosura pranë komisionit tonë, do të dorëzojnë raportet e tyre. Pra, ne duhet të presim që këto institucione të sjellin raportet e tyre brenda këtij muaji, të bëjmë dëgjesa me ta dhe, më pas, të miratojmë projektrezolutat dhe këto institucione, më pas, mbrojnë raportin vjetor të aktivitetit në parlament në një seancë speciale.

Këtë muaj ne duhet të njohemi me raportet, ndërkohë që sekretaria ka si detyrë të shohë nëse janë depozituar, por javën e parë të muajit prill duhet të punojmë me to. Përveç kësaj, duke parë edhe të gjitha projektligjet që janë depozituar në Kuvend, ju e dini që për momentin nuk ka asnjë projektligj për komisionin tonë, qoftë për dhënie mendimi apo miratimin e një projektligji të caktuar. Por neve na kanë ngelur edhe disa gjëra që duhet t'i bëjmë, siç janë vijimi i vizitave në disa site kulturore të vendit, si dhe një takim që duhet të bëjmë në Universitetin e Sporteve, pas takimit të hapur që Kryeministri bëri me Federatën Shqiptare të Futbollit. Gjithashtu, duhet të shohim postën që ka ardhur për komisionin tonë, që ka të bëjë me kthim përgjigjesh, por edhe me disa aktivitete.

Ju e dini që para 1 viti ne kemi pritur në komisionin tonë komisionin homolog të Kosovës dhe ata na kanë bërë një ftesë, për të bërë një vizitë në parlamentin e Kosovës. Ftesa është depozituar dhe nëse ju do të bini dakord, ne dje kemi hartuar një shkresë me ndihmën e sekretarisë në drejtim të zotit Ruçi, për të na dhënë leje për ta bërë këtë vizitë dhe, më pas, sekretaria do të fillojë të negociojë periudhën se kur do të bëhet kjo vizitë.

A jeni dakord? Po.

Ju lutem, hidhini një sy kalendarit dhe në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, depozitoheni në sekretari!

Sa i takon kalendarit doja t'ju thosha edhe diçka tjetër. Vjet ne kemi bërë disa vizita nëpër shtet e trashëgimisë kulturore. Kolegëve të pranishëm besoj se u kujtohet që disa prej këtyre vizitave na i mundësoi OSBE-ja, ndërkohë që një vizitë që kemi lënë me OSBE-në është ajo që duhet të bëjmë në qytetin e Korçës. Pra, sa i takon vizitës në muzeun e Korçës, duhet ta diskutojmë me përfaqësuesit e OSBE-së, pasi ndoshta edhe ata mund të kenë dëshirë t'i bashkohen kësaj vizite. Sa u takon vizitave që kemi në plan për të bërë në qytetin e Shkodrës, në Apoloni dhe në Bylis, këto janë vizita të planifikuara nga komisioni.

Dje, kur po punoja me Arianën dhe Muhametin, një nga gjërat që diskutuam ishte edhe një çështje që lidhet me mënyrën se si do të bëheshin procesverbalet e vizitave. Në komisione ne kemi mikrofona ambientale, të cilët edhe kur flasim nga distance, na regjistrojnë, por në vizita të tilla më shumë përdorim diktofonët. Tani që është vendosur teknologjia e re nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Botimeve nuk pranohet që ne të raportojmë me diktofon dhe për këtë arsye duhet të përgatisim vetë materialet për vizitën që do të jenë procesverbali i përmbledhur për ato që kemi parë në vizitë, si dhe listëprezenca, prandaj nga këtej e tutje këtë gjë duhet ta kemi parasysh, sepse nuk do të jetë më praktika e ndjekur deri tani.

A jeni dakord me kalendarin?

Sa i përket përcaktimit të datave, do të bisedojmë edhe me OSBE-në. Për Bylisin dhe Apoloninë do ta diskutojmë me Ismetin, ndërsa Shkodrën e ka marrë përsipër Mirela.

Muhamet Bela – Unë mendoj se është e vështirë të bëhet brenda një ditë.

Milva Ekonomi – Pasi të diskutohet me OSBE-në, Mirelën dhe Ismetin, do t'ju lajmërojmë për datën fikse.

Adelina Rista- Vizitat në Bylis dhe Apoloni duhen bërë veç e veç, sepse janë dy drejtime të ndryshme.

Bujar Çela - Unë mendoj se Apolonia dhe Bylisi bëhen në një ditë, ndryshe nuk jemi me hapin e qeverisë, e cila bën shumë takime frytdhënëse në një ditë.

Adelina Rista- Ti flet si i Ardenicës, unë flas si e Apollonisë. Unë kisha një ide që, kur të vini në Fier, do t'ju çoja në një shkollë 9-vjeçare që është bërë model, pastaj në një shkollë të mesme që është bërë model, pastaj të shkonim në Apoloni. Unë mendoj se duhen bërë veç e veç, nuk mund të dal kundër shumicës, por ky është mendimi im.

Fadil Nasufi - I bashkohem mendimit të Adelinës dhe të kombinojmë vizitën në sitin historik, me vizitat në institucionet e arsimit. Kolegët e Fierit të evidentojnë agjendën dhe ne t'i kushtojmë një ditë Fierit dhe Apollonisë. Një ditë tjetër do të shkojmë në Bylis, por të futet në agjendë edhe Kosova.

Milva Ekonomi- Duhet të marrim dakordësinë nga Kryetari i Kuvendit për vizitën në Kosovë.

Atëherë, biem dakord me mendimin e Adelinës.

Ismeti sot për arsye pune është në Mallakastër dhe ka sjellë disa shënime për kalendarin, të cilat lidhen me disa shqetësime, ndaj duhej që të kishte zëvendësues.

Shqetësimi i dytë ishte lidhur me kërkesën që është depozituar në komision, por ne do ta kontrollojmë, lidhur me profesionin e hidroteknikut. Ka ardhur një kërkesë nga shoqata e Hidroteknikëve të Shqipërisë.

(Diskutim pa mikrofon)

Këtë gjë duhet t'ia bëjmë me dije edhe Ismetit, që nuk ka ardhur te ne, por do të trajtohet nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese. Nuk mbaj mend që ta kemi pasur këtë dokument në komisionin tonë.

Faleminderit, Ariana për sqarimin!

Kemi gjë tjetër për të shtuar?

(Diskutim pa mikrofon.)

Po, pra! Por siç dëgjuat sqarimin, nuk është për dhënie mendimi nga ana e komisionit tonë.

Lidhur me kalendarin, nuk kemi gjëra të tjera për të shtuar. Datat do të konsiderohen të vendosura, kur të flasim me palët që kanë përgjegjësinë.

Keni ndonjë çështje tjetër që ju shqetëson? Ju e dini që në kushtet në të cilat jemi aktualisht, duhet të përdorim mirë të gjitha instrumentet parlamentare që na jep ne funksioni.

Unë do të bëj edhe një propozim tjetër, mbase duhet të fillojmë të mendojmë që të bëjmë dia dëgjesa me institucionet e varësisë së komisionit. Për shembull, me ministren e re të Kulturës,

me ministren e re të Arsimit, me institucionet e tjera të varësisë që kemi. RTSH-ja dhe AMA do të vijnë së shpejti për raportin vjetor, por, të paktën, të fillojmë të bëjmë dëgjesat normale për çështje të ndryshme. Çështjet mund të jenë të lidhura me “Paktin për Universitetin”, me trajtimin e sajteve historike, me mënyrën se si po ndodh vendimmarrja ose si po ecën ligji i ri “Për trashëgiminë kulturore” e të tjera. Mbase, mund t’i japim si detyrë një grupi të vogël nga ana jonë, për shembull, zonjës Nikolla dhe zotit Roshi, që të bashkëpunojnë për të caktuar një temë dëgjese për ministren e Arsimit, ose t’u japim zonjës Rista dhe zonjës Kumbaro detyrë për të përgatitur një temë për dëgjesë me ministren e re të Kulturës. Do të ishte shumë mirë të kemi parasysh që edhe këto t’i vendosim në kalendar.

Ndryshe nga më parë, unë besoj se ne duhet të biem dakord me ministrat për dëgjesat, sepse agjenda e ministrave, pavarësisht dëshirës që kemi ne për dëgjesë, ka ngarkesën e vet. Pra, t’u japim mundësi që në harkun kohor të dhjetë ditëve, të na kthejnë përgjigje kur munden të vijnë për këtë dëgjesë.

A jeni dakord?

Bujar Çela – Ne, si komision, mund të kërkojmë edhe interpelancë në parlament me një nga këta ministra.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Unë mendoj që të bëjmë një herë dëgjesat, sepse ne kemi çështje që mund të bëjmë interpelancë, por duhet të shikojmë se cila është çështja.

Mirela Kumbaro – Në fakt, edhe unë këtë doja të thosha, që para se të bëjmë kërkesë për interpelancë, duhet ta kemi të justifikuar mjaftueshëm mirë dhe mos ta bëjmë thjesht si një instrument që ne duhet ta përdorim.

Ka një lloj gradacioni dhe unë besoj se, edhe ne, por besoj se edhe ministrat e rinj i ndihmon dëgjesa me komisionin për temat që kanë në proces.

Dëgjesa pastaj do të na tregojë, nëse kemi nevojë për të bërë interpelancë për një çështje të caktuar. Interpelancën mund ta kërkojë qoftë edhe një grup deputetesh, se jam dakord që nuk e bën komisioni interpelancën.

Milva Ekonomi – Urdhëroni, zoti Bela, këshilltari i komisionit!

Muhamet Bela – Unë kam një mendim në lidhje me thirrjen e ministres së Kulturës në komision. Meqenëse ju, si komision, do të bëni vizitë në parkun Arkeologjik të Apollonisë, të Bylisit apo në Muzeun Kombëtar Mesjetar të Korçës, pasi të kryhen këto, duke u ballafaquar me bazën atje, duke parë problematikat do të ishte mirë që pastaj të thirrej ministrja për dëgjesë.

E thashë këtë sugjerim, meqenëse e gjithë kjo ka lidhje me ligjin “Për trashëgiminë kulturore”.

Milva Ikonomi – Të shikojmë se çfarë temash do të gjejnë Mirela me Adelinën dhe pastaj vendosim.

Jeni të gjithë dakord për miratimin e kalendarit? Dakord.

A ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar? Nuk ka.

E lëmë që të takohemi në parlament në seancën e ditës së enjte.

Ata që morën një detyrë të vogël grupi, të bashkëpunojnë të enjten dhe të vendosin për temat, të cilat ndërkohë ia nisim ministreve përkatëse, për të na kthyer përgjigje për prezencën.

Ju faleminderit shumë!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi dhe vendimi për rihapjen e procesit të kandidimit për vakancat në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Miratimi i vendimit nr. 5/1.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Enver Reçi, Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fidel Ylli, Ismet Beqiraj.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Në këtë mbledhje duhet të marrim një vendim të rëndësishëm, i cili ka të bëjë me kandidaturat për Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Ju e dini se ka një ligj që orienton punën e Radiotelevizionit Shqiptar, një ligj të përmirësuar lidhur me Këshillin Drejtues të tij. Ne bëmë një ftesë - thirrje për pozicionet vakante për 3 kandidatura, por në ligj thuhet që për çdo kandidaturë, duhet të ketë 4 kandidatë. Në fakt, pasi thirrja ishte e hapur për 1 muaj, për 3 kandidaturat që u hapën, erdhën vetëm 7 kandidatë. Kështu që na duhet të marrim një vendim se si duhet të veprojmë më tej dhe, natyrisht, duhet të konsultohemi dhe të kemi mbështetjen e sektorit juridik këtu, në Kuvend.

Do t'i lutesha zotit Bici të na bënte një përmbledhje të shkurtër për veprimet e mëtejshme të komisionit në lidhje me këtë çështje.

Gazmend Bici – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Lidhur me vakancat në RTSH, siç e thatë edhe ju, aktualisht janë 3 vende vakante, të cilat i përkasin maxhorancës. Për këto vakanca komisioni ka marrë një vendim dhe ka publikuar vendet vakante për këtë këshill, ndërkohë që kanë ardhur 7 kandidatura nga 12 që duhet të vinin. Ligji përcakton se duhen 4 kandidatura për çdo vend vakant. Në këto kushte, sugjeroj që komisioni të marrë një vendim për rishpalljen e vakancave, duke u dhënë një afat kohor prej 3 ditësh, siç përcakton ligji, për ardhjen e kandidaturave të reja.

Pas kësaj procedohet me...

Milva Ekonomi – Pyetja që kam unë është: 7 kandidaturat që kanë ardhur do t'i quajmë të mirëqena?

Gazmend Bici – Po, do t'i quajmë të mirëqena.

Milva Ekonomi – Domethënë, ato do të marrin pjesë në garë, se është e rëndësishme ta sqarojmë.

Gazmend Bici – Duhet minimalisht edhe 5 kandidatura të tjera. Kjo është situata.

Milva Ekonomi – Biem dakord për këtë gjë?

Atëherë, do të marrim vendimin që të rishpallim vakancën e këtyre pozicioneve në RTSH dhe kjo vakancë do të mbetet e hapur për 30 ditë. Pastaj, kur të vijnë propozimet e reja për Këshillin Drejtues, do t'ia kalojmë Shërbimit të Monitorimit për të parë se cilat kandidatura janë paraqitur dhe nëse ato i plotësojnë të gjitha kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit Drejtues dhe ne do të marrim vendimin për të vepruar më tej.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aktualisht po bëjmë rishpalljen. Ato kandidatura që kanë ardhur po i shikon Shërbimi i Monitorimit, këtë dua të theksoj. Pra, hapet kandidimi, kontrollohen kandidaturat dhe vijnë këtu në komision për miratim.

Jeni dakord për të vepruar në këtë mënyrë?

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA